



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs*

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**  
**NR. 26/2012 - MPB**

**PËR UNIFORMËN DHE SIMBOLET E NJËSIVE PROFESIONALE TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION**  
**NO. 26/2012 - MIA**  
**ON THE UNIFORM AND SYMBOLS OF PROFESSIONAL FIRE FIGHTING AND RESCUE UNITS**

**ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA**  
**BR. 26/2012 – MUP**  
**ZA UNIFORMU I SIMBOLE PROFESIONALNIH JEDINICA ZA GAŠENJE POŽARA**



<p><b>Republika e Kosovës</b> <b>Qeveria</b> <b>Ministria e Punëve të Brendshme</b></p> <p>Në mbështetje të nenit 8, paragrafit 5 të Ligjit nr. 04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim, si dhe nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Ministri i Punëve të Brendshme,</p> <p>nxjerr:</p> <p><b>UDHËZIM ADMINISTRATIV</b></p> <p><b>Nr. 26/2012</b></p> <p><b>PËR UNIFORMËN DHE SIMBOLET E NJËSIVE PROFESIONALE TË ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT</b></p> <p><b>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <p>Me këtë udhëzim administrativ përcaktohet lloji, modeli, përbërja e uniformës së punës</p>	<p><b>Republic of Kosovo</b> <b>Government</b> <b>Ministry of Internal Affairs</b></p> <p>Pursuant to article 8 paragraph 5 of the Law no. 04 / L – 049 on Fire fighting and Rescue as well as article 38 paragraph 6 of the Government’s Rules of Procedures of the Republic of Kosovo No. 09/2011, the Minister of Internal Affairs</p> <p>issues:</p> <p><b>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION</b></p> <p><b>No. 26/2012</b></p> <p><b>ON THE UNIFORM AND SYMBOLS OF THE PROFESSIONAL FIRE FIGHTING AND RESCUE UNIT</b></p> <p><b>GENERAL PROVISIONS</b></p> <p><b>Article 1</b> <b>Purpose</b></p> <p>By the means of this Administrative Instruction are determined the type, model,</p>	<p><b>Republika Kosova</b> <b>Vlada</b> <b>Ministarstvo Unutrasnjih Poslova</b></p> <p>Na osnovu člana 8 stavke 5 zakona br. 04/L-049 za gasenje požara i spašavanje kao i člana 38 stavka 6 Poslovnika rada Vlade Republike Kosova Br. 09/2011, Ministar Unutrašnjih Poslova</p> <p>donosi:</p> <p><b>ADMINISTRATIVNO UPOUTSTVO</b></p> <p><b>Br. 26.2012</b></p> <p><b>ZA UNIFORMU I SIMBOLE PROFESIONALNIH JEDINICA ZA GAŠENJE POŽARA I SPAŠAVANJE</b></p> <p><b>OPŠTE ODREDBE</b></p> <p><b>Član 1</b> <b>Svrha</b></p> <p>Ovim Administrativnim Uputstvom se utvrđuje vrsta, model, sastojci radne</p>
--	---	---



<p>dhe uniformës solemne, veshmbathjeve shtesë, kohëzgjatja e përdorimit të tyre, simbolet, emërtimet dhe shenjat e funksioneve të pjesëtarëve të njësive profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit në Republikën e Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura për qëllim të këtij udhëzimi administrativ kanë kuptimin si në vijim:</p> <p>1.1 <b>NJPZSH</b> - nënkupton Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit.</p> <p>1.2 <b>DZSH</b>- nënkupton Drejtoria për Zjarrfikje dhe Shpëtim.</p> <p>1.3 Simbolet- në kuptim të këtij udhëzimi administrativ nënkupton simbolet e NJPZSH-së dhe shenjat në uniformën e pjesëtarëve të NJPZSH-së.</p> <p>1.4 <b>Kombinizoni</b>—nënkupton llojin e uniformës së punës për pjestarë të NJPZSH-së, modeli i së cilës dallon nga uniforma e punës pasi që është e përbërë vetëm prej një pjese që mbulon trupin dhe gjymtyrët e personit.</p> <p>2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin ashtu</p>	<p>composition, of the work uniform and solemn uniform, additional clothing, the duration of their use, symbols, designations and the functions insignia of members of professional fire fighting and rescue unit in the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Definitions</b></p> <p>1. Expressions used for the purpose of this Administrative Instruction shall have the following meaning:</p> <p>1.1. PFRU – shall mean the professional fire fighting and rescue Unit</p> <p>1.2. DFR – shall mean the Department for Fire fighting and rescue</p> <p>1.3. Symbols – in terms of this AI shall mean the symbols of PFRU and the signs in the uniform of PFRU members</p> <p>1.4. Shift – shall mean the type of work uniform for PFRU members, the model of which shall distinguish from the work uniform as it is made only from one part that covers the body and the limbs of the person.</p> <p>2. Other expressions used in this Administrative Instruction shall have the</p>	<p>uniforme i sveçane uniforme, dodatne odeće i obuće, rok njihove upotrebe, simboli, nazivi i znakovi funkcija članova profesionalnih jedinica za gašenje požara i spašavanja u Republici Kosova.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2</b> <b>Definicije</b></p> <p>1. Upotrebljeni izrazi za svrhu ovog Administrativnog Uputstva imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1 PJGPS-Podrazumeva Jednicu za Gašenje Požara i Spašavanje.</p> <p>1.2 DGPS-Podrazumeva Department za Gašenje Požara i Spašavanje.</p> <p>1.3 Simboli-u značenju ovog AU podrazumeva simbole PJGSP-a i zankove na uniformi članova PJGSP-a.</p> <p>1.4 Kombinizon-podrazumeva vrstu radne uniforme za članove PJGSP-a, model koji se razlikuje od radne uniforme pošto je ona sačinjena samo od jednog dela koja pokriva telo i udove lica.</p> <p>2. Ostali upotrebljeni izrazi u ovoj administrativnog uputstva značenje onako</p>
--	--	---



<p>siç përcaktohet në Ligjin Nr. 04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim, si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3</b> <b>Uniforma për zjarrfikës</b></p> <p>1. Uniforma për zjarrfikës përfshinë uniformën e punës dhe uniformën solemne e cila shenjëzohet me simbolin e njësisë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, si dhe shenjat e funksioneve që pjesëtarët e njësisë i ushtrojnë në njësitë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>2. Uniforma nga paragrafi 1 i këtij neni vlen edhe për të gjithë instruktorët të cilët mbajnë trajnime për zjarrfikës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 4</b> <b>Mbajtja e uniformës</b></p> <p>1. Gjatë orarit të punës zjarrfikësit obligohen të mbajnë uniformën e punës e cila është unike për pjesëtarët e të gjithë NJPZSH-ve, në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>2. Uniformën e punës, pjesëtarët e njësisë</p>	<p>meaning as it is defined in the Law No. 04 / L – 049 on Fire fighting and Rescue as well as with the relevant applicable legislation.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3</b> <b>Uniform for fire fighters</b></p> <p>1. The uniform for fire fighter shall include the work uniform and the solemn uniform which is marked with the symbol of the professional fire fighting and rescue unit, as well as with the function insignia that members of the unit exercise in the professional fire fighting and rescue unit in compliance with provisions of this Administrative Instruction.</p> <p>2. The uniform under paragraph 1 of this article applies as well to all instructors who attend training on fire fighting.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 4</b> <b>Wearing the uniform</b></p> <p>1. During the working time, the fire fighters shall be obliged to wear the work uniform which is unique for the members of the entire PFRU, in compliance with the provisions of this Administrative Instruction.</p> <p>2. Members of the professional fire fighting</p>	<p>kako je utvrđeno u Zakonu Br. 04/L-049 za Gašenje Požra i Spašavanje, kao i dotičnim zakonodavstvom na snagu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3</b> <b>Uniforma za Vatrogasce</b></p> <p>1. Uniforma za vatrogasce obuhvaća radnu uniformu kao i svečanu uniformu koja se označava sa simbolom profesionalne jedinice za Gašenje Požara i Spašavanje i znaci funkcije pripadnika jedinice koji deluju u profesionalnu jedinicu za gašenje požara I spasavanje u skladu sa odredbama ovog administrativnog upustva.</p> <p>2. Uniforma iz stavke 1 ovog člana vazi i za sve instruktore koji drže obuke za vatrogasce.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 4</b> <b>Održavanje Uniforme</b></p> <p>1. Tokom radnog vremena, vatrogasci se obavezuju da nose radnu uniformu koja je jedinstvena za sve članove PJGPS-a, u skladu sa odredbama ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p>2. Radnu uniformu članovi profesionalnih</p>
--	--	--



<p>profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit obligohen ta mbajnë edhe me rastin e mbajtjes së trajnimeve dhe aftësimit profesional, gjatë kryerjes së punëve për mirëmbajtjen e pajisjeve zjarrfikëse, si dhe zjarrfikësit praktikantë gjatë kohës së kryerjes së stazhit të praktikantit.</p> <p>3. Uniformën solemne, pjesëtarët e njësisë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit e mbajnë me urdhër të eprorit të njësisë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit me rastin e ndonjë solemniteti, garave zjarrfikëse dhe nderimeve të cilat i organizon NJPZSH ose kur janë të ftuar të marrin pjesë në manifestime të ndryshme publike.</p> <p>4. Uniforma mbrojtëse dhe pajisjet mbrojtëse për NJPZSH-të rregullohen me akt të veçantë juridik.</p>	<p>and rescue unit shall wear the work uniform even in the case of training and vocational training, when performing works for the maintenance of fire fighting equipments, as well as intern fire fighters during the period of internships performance.</p> <p>3. Members of the professional fire fighting and rescue unit shall wear the solemn uniform under the order of the superior of professional fire fighting and rescue unit on the occasion of solemnity, fire fighting contests and honor events which are organized by PFRU or when the members are invited to participate in various public manifestations.</p> <p>4. The protective uniform and protective equipments for PFRU shall be regulated by a special legal act.</p>	<p>jedinica za gašenje požara i spašavanje se oabvezuju da je nose i prilikom održavanja obuke i profesionalnog osposobljavanja, tokom izvršavanja poslova za održavanje opreme za gašenje požara, kao i vatrogasci pripravnici tokom radnog vremena u izvršavanju staža pripravnika.</p> <p>3. Svečanu uniformu članovi profesionalne jedinice za gašenje požara i spašavanje nose po naređenju starešine profesionalne jedinice za gašenje požara i spašavanje prilikom neke svečanosti, takmičenja za gašenje požara i zahvalnosti koje organizuje PJGPS-nje ili kada su pozvani da učestvuju u razne javne manifestacije.</p> <p>4. Zaštitna uniforma kao i zaštitna oprema za PJGPS-nje se regulišu posebnim pravnim aktom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Modeli i uniformës së punës të pjesëtarëve të NJPZSH-së</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>The model of work uniform for PFRU members</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Model radne uniforme za članove PJGPS</b></p>
<p>1. Modeli i uniformës së punës e cila nënkupton uniformën verore dhe dimërore, është e njëjtë për të gjitha NJPZSH-të në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Uniforma e punës për pjesëtarë të</p>	<p>1. The model of work uniform which indicates the summer and winter uniform shall be the same for all PFRU in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Work uniform for the PFRU members</p>	<p>1. Model radne uniforme koja podrazumeva letnju i zimsku uniformu je ista za sve PJGPS-a u Republiku Kosova.</p> <p>2. Radna uniforma za članove PJGPS-a je</p>



<p>NJPZSH-së është e njëjta për të dy gjinitë dhe përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>2.1. kapela,</li><li>2.2. këmisha,</li><li>2.3. pantallonat,</li><li>2.4. xhaketa,</li><li>2.5. <b>xhupi</b>,</li><li>2.6. fanella me mëngë të shkurtë,</li><li>2.7. dorëzat e punës,</li><li>2.8. manteli mbrojtës nga shiu,</li><li>2.9. rripi për pantallona,</li><li>2.10. këpucët verore dhe dimërore,</li><li>2.11. kombinezoni për automekanik.</li></ol>	<p>shall be the same for both genders and shall consist of:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>2.1. cap,</li><li>2.2. dress shirt,</li><li>2.3. trousers,</li><li>2.4. blazer,</li><li>2.5. Jacket</li><li>2.6. shirt with short sleeves – T shirts,</li><li>2.7. work gloves,</li><li>2.8. rain protection coat,</li><li>2.9. belt for trousers,</li><li>2.10. summer and winter shoes</li><li>2.11. shift for auto mechanist</li></ol>	<p>ista za oba pola i sastoji se od:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>2.1. kapa,</li><li>2.2. Košulje,</li><li>2.3. pantalone,</li><li>2.4. prsluka,</li><li>2.5. jakna</li><li>2.6. bluza sa kratkim rukavima-majica,</li><li>2.7. radne rukavice,</li><li>2.8. zaštitni mantil za kišu</li><li>2.9. kaiš za pantalone,</li><li>2.10. letnje i zimske cipele,</li><li>2.11. kombinezon za automehaničara</li></ol>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b></p> <p>Detajet rreth modelit dhe specifikave teknike për uniformën e punës sipas nenit 5, paragrafit 2 të këtij udhëzimi administrativ janë të përcaktuara në shtojcën 1 e cila është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b></p> <p>Details about the work uniform model and technical specifications under article 5 paragraph 2 of this Administrative Instruction are laid down in the appendix 1 which is an integral part of this Administrative Instruction</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b></p> <p>Detalji oko modela i tehničkih specifikacija za radnu uniformu prema članu 5, stavka 2 ovog Administrativnog Uputstva su utvrđeni u prilogu 1 koja je i sastavni deo ovog Administrativnog Uputstva.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Modeli i uniformës solemne të pjesëtarëve të NJPZSH-së</b></p> <p>1. Modeli i uniformës solemne e cila nënkupton uniformën verore dhe dimërore, është e njëjtë për të gjitha NJPZSH-të në Republikën e Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>The model of PFRU members solemn uniform</b></p> <p>1. The solemn uniform model which shall indicate the summer and winter uniform shall be the same for all PFRU members in the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Model Svečane uniforme članova PJGPS</b></p> <p>1. Model Svečane uniforme koja podrazumeva letnju i zimsku uniformu istu za sve PJGPS-nje u Republici Kosova.</p>



<p>2. Uniforma solemne për pjesëtarët e NJPZSH-së përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>2.1. kapela solemne,</li><li>2.2. bereta për femra,</li><li>2.3. sakoja,</li><li>2.4. pantallonat,</li><li>2.5. fundi,</li><li>2.6. pallto,</li><li>2.7. këmisha verore dhe dimërore,</li><li>2.8. kollarja,</li><li>2.9. këpucët,</li><li>2.10. dorëzat e bardha.</li></ol> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b></p> <p>Detajet rreth modelit dhe specifikave teknike për uniformën solemne sipas nenit 7, paragrafit 2 të këtij udhëzimi administrativ, janë të përcaktuara në shtojcën 2 e cila është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Veshëmbathja shtesë</b></p> <p>1. Veshëmbathja shtesë është pjesë përbërëse e uniformës së punës dhe solemne të zjarrfikësve me model dhe prerje standarde, ndërsa përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1.1. trikoja,</li><li>1.2. jeleku i punës,</li></ol>	<p>2. The solemn uniform for PFRU members shall consist of:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>2.1. Solemn hat,</li><li>2.2. Berets for females,</li><li>2.3. Blazer,</li><li>2.4. Trousers,</li><li>2.5. Skirt,</li><li>2.6. Coat,</li><li>2.7. Summer and winter dress shirts</li><li>2.8. Tie,</li><li>2.9. Shoes,</li><li>2.10. White gloves.</li></ol> <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b></p> <p>Details about the solemn uniform model and technical specifications under article 7 paragraph 2 of this Administrative Instruction are laid down in the appendix 2 which is integral part of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Additional clothing</b></p> <p>1. Additional clothing shall be integral part of the work and solemn uniform of fire fighters with standard model and cut, which it consist of:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1.1. Sweater</li><li>1.2. Work vest</li></ol>	<p>2. Svečana uniforma za članove PJGPS-nje se sastoji od:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>2.1. svečana kapa,</li><li>2.2. Bereta za ženske,</li><li>2.3. sako,</li><li>2.4. pantalone,</li><li>2.5. suknja,</li><li>2.6. mantil,</li><li>2.7. letnja i zimska košulja,</li><li>2.8. kravata,</li><li>2.9. cipele,</li><li>2.10. bele rukavice.</li></ol> <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b></p> <p>Detalji oko modela i tehničkih specifikacija za svečanu uniformu prema članu 7, stavka 2 ovog Administrativnog Uputstva su utvrđeni u prilogu 2 koja je i sastavni deo ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Dodatne odeća i obuća</b></p> <p>1. Dodatna odeća i obuća je sastavni deo radne i svečane uniforme za vatrogasce sa standardnim modelom i krojom, i sastoji se od:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1.1. Đempera,</li><li>1.2. Radnog prsluka</li></ol>
--	---	---



<p>1.3. çorapat verore dhe dimërore, 1.4. dorëzat, 1.5.pajisjet sportive- kostumi sportiv, fanella dhe atletet.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b></p> <p>Detajet rreth modelit dhe specifikave teknike për veshëmbathjen shtesë sipas nenit 9 të këtij udhëzimi administrativ, janë të përcaktuara në shtojcën 3 e cila është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b> <b>Kohëzgjatja e përdorimit të uniformës</b></p> <p>1. Uniforma e punës, uniforma solemne dhe veshëmbathjet shtesë si ato verore ashtu edhe ato dimërore, kanë kohëzgjatjen e përdorimit si në vijim:</p> <p>1.1. kapela 2 copë - tri vite, 1.2. këmisha 4 copë - një vit, 1.3. pantallona 4 palë - një vit, 1.4. xhaketa 2 copë - dy vite, 1.5. <b>xhupi</b> 1 copë - pesë vite, 1.6. fanellë me mëngë të shkurta 4 copa-një vit, 1.7. dorëzat e punës një palë - një vit, 1.8. manteli për mbrojtje nga shiu 1 copë-një vit,</p>	<p>1.3. Summer and winter stockings 1.4. Gloves 1.5. Sports equipments – sports wears, sports shirt and sneakers.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b></p> <p>Details of the additional clothing model and technical specification under article 9 of this Administrative Instruction are laid down in appendix 3 which is an integral part of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b> <b>Duration of uniform use</b></p> <p>1. Work uniform, solemn uniform and the additional clothing, both summer and winter ones, shall have the following duration of use:</p> <p>1.1. Hat 2 pieces, - there years, 1.2. Dress shirt 2 pieces, - one year, 1.3. Trousers 2 pieces, - one year, 1.4. Blazer 2 pairs, - to years. 1.5. Jacket 1 pair, - five years, 1.6. Shirt with short sleeves 1 pairs – one year, 1.7. Work gloves one pair – one year, 1.8. Rain protection coat 1 pair – one year,</p>	<p>1.3. Letnih i zimskih čarapa, 1.4. Rukavica 1.5. Sportske opreme-trenerki, dresovi i patike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b></p> <p>Detalji oko modela i tehničkih specifikacija za Dodatnu odeću i obuću prema članu 9, ovog Administrativnog Uputstva su utvrđeni u prilogu 3 koja je i sastavni deo ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b> <b>Rok upotrebe uniforme</b></p> <p>1. Radna uniforma, svečana uniforma kao dodatna odeća i obuća kao one letnje takodje i one zimske imaju rok upotrebe kao u nastavku:</p> <p>1.1 kape 2 komada, -tri godine, 1.2 košulje 4 komada,-jedna godina, 1.3 pantalone 4 para,-jedna godina, 1.4 prsluci 2 komada,-dve godine, 1.5 jakna 1 komad,-pet godina, 1.6 bluza sa kratkim rukavima 4 komada,-jedna godina, 1.7 radne rukavice 1 par,-jedna godina, 1.8 zaštitni mantil za kišu 1 komad,- jedna godina,</p>
--	--	--





<p>1.9. rripi për pantallona 1 copë- dy vite,</p> <p>1.10. këpucë verore 1 palë - një vit,</p> <p>1.11. këpucë të thella dimërore 1 palë –një vit.</p> <p>1.12. triko 1 copë-dy vite,</p> <p>1.13. jeleku i punës 1 copë - dy vite,</p> <p>1.14. çorapët 6 palë - një vit,</p> <p>1.15. dorëza të lëkurës 1 palë - dy vite.</p> <p>2.Uniforma solemne ka kohëzgjatjen e përdorimit pesë vite.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12</b> <b>Përfundimet e kohëzgjatjes së përdorimit</b></p> <p>1. Uniformat e përcaktuara në nenin 5, 7 dhe 9 të këtij udhëzimi administrativ, mund të ndërrohen edhe para kalimit të kohëzgjatjes së përdorimit të përcaktuara në neni 11 të këtij udhëzimi administrativ, me kusht që të jenë të dëmtuara ose plotësisht të shkatërruara gjatë kryerjes së veprimtarisë zjarrfikëse ose nuk mund të shfrytëzohen më.</p> <p>2. Ndërrimi i uniformës nga paragrafi 1 i këtij neni, i lejohet zjarrfikësit me miratimin e eprorit të njësisë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit.</p>	<p>1.9. Trousers belt 1 piece – two years,</p> <p>1.10. Summer shoes 1 pairs – one year,</p> <p>1.11. Deep winter footwear 1 pair – one year,</p> <p>1.12. Sweater 1 pair – two years,</p> <p>1.13. Work vest 1 piece – two years,</p> <p>1.14. Stockings 6 pairs – one year,</p> <p>1.15. Leather gloves 1 pair – two years.</p> <p>2. The solemn uniform use duration shall be five years.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12</b> <b>Exceptions to the duration of use</b></p> <p>1. Uniforms determined in article 5, 7 and 9 of this Administrative Instruction may be changed even prior to the expiry of duration of use as laid down in article 11 of this Administrative Instruction provided that are damaged or are fully destroyed during the performance of fire fighting activity or they cannot be used any longer.</p> <p>2. The change of uniform under paragraph 1 of this article shall be allowed to the fire fighter by the approval of the professional fire fighting and rescue unit superior.</p>	<p>1.9 kaiš za pantalone 1 komad,-jdena godina,</p> <p>1.10 letnje i zimske cipele 1 par, jedna godina,</p> <p>1.11 zimske duboke cipele 1 par,-dve godine,</p> <p>1.12 đemper 1 komad,-dve godine,</p> <p>1.13 radni prsluk 1 komad,-dve godine,</p> <p>1.14 čarape 6 para,- jedna godina,</p> <p>1.15 Kožne rukavice 1 par,-dve godine</p> <p>2. Rok upotrebe Svečana uniforme je pet godina.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12</b> <b>Izuzetci roka upotrebe</b></p> <p>1. Određene uniforme u članu 5, 7 i 9 ovog Administrativnog Uputstva modu se izmeniti i pre isteka roka upotrebe utvrđene u članu 11 ovog Administrativnog Uputstva pod uslovom da us oštećene ili potpuno uništene tokom izvršavanja poslova u gašenju požara ili su neupotrebljive.</p> <p>2. Zamena uniforme iz stvake 1. ovog člana se dozvlajava vatrogascu sa odobrenjem starešine profesionalne jedinice za gašenje požara i spašavanje.</p>
---	--	--



<p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b> <b>Vazhdimi i kohëzgjatjes së përdorimit të uniformës</b></p> <p>1. Vazhdimi i kohëzgjatjes së përdorimit të uniformës së zjarrfikësve bëhet në rastet:</p> <p>1.1. kur zjarrfikësi ka qenë i larguar nga detyra, 1.2. pushimit mjekësor, 1.3. kur ka ndërruar vendin e punës ku nuk mbahet uniforma, 1.4. kur është para skadimi të kontratës së punës, për shkak të shkuarjes në pension të cilit i ka mbetur më pak se gjashtë muaj.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 13</b> <b>Extension of duration of uniform use</b></p> <p>1. The extension of uniform use duration for fire fighter is made in the following cases:</p> <p>1.1. When the fire fighter has been removed from the duty 1.2. Medical leave 1.3. When he has changed the working place where the uniform is not applied 1.4. When the work contracts is almost expiring, due to the retirement and there are less than six months left.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 13</b> <b>Produženje roka upotrebe Uniforme</b></p> <p>1. Produženje roka upotrebe uniforme za vatrogasce se vrši u slučajevima kada:</p> <p>1.1. kada vatrogasac bio udaljen sa dužnosti, 1.2. bolovanja, 1.3. kada je promenio radno mesto gde se ne nosi uniforma, 1.4. kada je pred istekom radnog ugovora, zbog odlaska u penziju kome je ostalo manje od šest meseci.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Kthimi i uniformës</b></p> <p>Pjesëtarit të njësisë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, të cilit i është ndërprerë kontrata e punës, anëtarësia ose është përcaktuar në ndonjë vend tjetër të punës, ku nuk është e nevojshme mbajtja e uniformës, është i obliguar ta kthejë uniformën si dhe të gjitha veshëmbathjet tjera me të cilat ka qenë i ngarkuar.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article</b> <b>Return of the uniform</b></p> <p>The professional fire fighting and rescue unit member to whom the work contract has been terminated, or who is assigned in another work place where the uniform is not necessary, shall be obliged to return the uniform, as well as all other clothing which he was obliged to wear.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Vračanje uniforme</b></p> <p>Članu profesionalne jedinice za gašenje požara i spašavanje kome je prekinut radni ugovor, članstvo ili je određen u neko drugo radno mesto gde nije potrebno da se nosi uniforma, on je obavezan da vrati uniformu, kao i svu ostalu odeću i obuću sa kojim aje on bio zadužen.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Mirëmbajtja e uniformës</b></p> <p>Uniforma e përcaktuar sipas dispozitave të</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Uniform maintenance</b></p> <p>The uniform defined under provisions of</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Održavanje uniforme</b></p> <p>Uniforma utvrđena prema odredbama ovog</p>



<p>këtij udhëzimi administrativ duhet të mirëmbahet rregullisht nga ana e pjesëtarëve të NJPZSH-së.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 16 Mbikëqyrja</b></p> <p>Eprori i njësisë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit është i obliguar të bëjë mbikëqyrjen e shfrytëzimit, vendosjes, ruajtjes dhe evidencës së uniformës së punës dhe uniformës solemne.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 17 Simbolet e NJPZSH-së</b></p> <p>1. Simbolet në kuptim të këtij udhëzimi administrativ për NJPZSH-në përfshin: flamurin dhe stemën identifikuese.</p> <p>2. Përzgjedhja e flamurit dhe stemës së NJPZSH-së bëhet përmes konkursit publik, pas të cilit njëra nga tri propozimet më të mira do t'i afrohet AME-së për miratim.</p> <p>3. Simbolet në uniformën e pjesëtarëve të NJPZSH-së përfshin:</p> <p>3.1 shenjat e funksionit; 3.2 shenjat e përkatësisë; 3.3. shenjat e fushëveprimit përkatës.</p>	<p>this AI shall be maintained regularly by the members of PFRU.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 16 Supervision</b></p> <p>The professional fire fighting and rescue unit superior shall be obliged to oversee the use, placement, preservation and evidence of work uniform and the solemn uniform.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 17 PFRU Symbols</b></p> <p>1. Symbols in term of this Administrative Instruction for PFRU include: the Flag and the Identification Seal.</p> <p>2. The selection of PFRU flag and seal shall be made through the public competition, after which three best proposals shall be offered EMA for approval.</p> <p>3. Symbols in the PFRU members uniform include:</p> <p>3.1. signs of the function 3.2. signs of affiliation 3.3. signs of respective scope.</p>	<p>AU treba da se održava redovno od strane članova PJGPS-nja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 16 Nadzor</b></p> <p>Starešina profesionalne jedinice za gašenje požara i spašavanje je obavezan da vrši nadzor korišćenja, smeštaja, čuvanja i evidentiranja radne uniforme i svečane uniforme.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 17 Simboli PJGPS</b></p> <p>1. Simboli u značenju ovog Administrativnog Uputstva za PJGPS uključuju: Zastavu i Grb raspoznavanja.</p> <p>2. Izbor zastave i grba PJGPS se vrši preko javnog konkursa, nakon kojeg jedan od tri najboljih predloga će biti dostavljena AEM-u za usvajanje.</p> <p>3. Simboli na uniformu članova PJGPS uključuju:</p> <p>3.1 zankove funkcije (položaja) 3.2 znakove pripadnosti 3.3 znakovi dotične oblasti delovanja</p>
---	--	---



<b>Neni 18</b> <b>Emërtimet e funksionit të pjesëtarëve të NJPZSH-së</b>	<b>Article 18</b> <b>Appointment of functions for PFRU members</b>	<b>Član 18</b> <b>Nazivi funkcija za članove PJGPS</b>
<p>1. Emërtimet e funksioneve të pjesëtarëve të NJPZSH-së sipas strukturës organizative të njësive profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit janë si në vijim:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1.1. Komandanti i Brigadës;</li><li>1.2. Zëvendës komandanti i Brigadës;</li><li>1.3. Komandanti i Batalionit;</li><li>1.4. Zëvendës komandanti i Batalionit;</li><li>1.5. Udhëheqës Togu;</li><li>1.6. Zëvendës Udhëheqës Togu;</li><li>1.7. Udhëheqës Skuadre;</li><li>1.8. Zv.Udhëheqës Skuadre;</li><li>1.8. Udhëheqës Grupi;</li><li>1.9. Zjarrfikës;</li><li>1.10. Zjarrfikës Praktikant.</li></ol>	<p>1. Appointments of the functions for PFRU members under the organizational structure of the professional fire fighting and rescue unit are as follows:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1.1. Commander of the brigade</li><li>1.2. Deputy commander of the brigade</li><li>1.3. Commander of battalion</li><li>1.4. Deputy commander of battalion</li><li>1.5. Head of platoon</li><li>1.6. Deputy head of platoon</li><li>1.7. Team leader</li><li>1.8. Deputy team leader</li><li>1.9. Group leader</li><li>1.10. Fire fighter</li><li>1.11. Intern fire fighter</li></ol>	<p>1. Nazivi za funkcije članova PJGPS prema organizativnoj strukturi profesionalnih jedinica za gašenje požara i spašavanje su kao u nastavku:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1.1. Komandant Brigade,</li><li>1.2. Zamenik komnadanta Brigade,</li><li>1.3. Komandant Bataljona,</li><li>1.4. Zamenik komandanta Bataljona,</li><li>1.5. Rukovodioc Voda,</li><li>1.6. Zamenik rukovodioca Voda,</li><li>1.7. Rukovodioc Odeljenja,</li><li>1.8. Zamenik rukovodioca Odeljenja,</li><li>1.8. Rukovodioc Grupe,</li><li>1.9. Vtraogasac,</li><li>1.10. Vatrogasac pripravnik,</li></ol>
<b>Neni 19</b> <b>Shenjat e funksionit</b>	<b>Article 19</b> <b>Sign of the function</b>	<b>Član 19</b> <b>Znakovi funkcije</b>
<p>1. Shenjat e funksioneve të NJPZSH-së janë të vendosura në paleta me dimenzionet 60 x110 mm prej pëlhure të fortë me ngjyrë të njëjtë si uniforma, të cilat vendosen në krahërorët e uniformës së zjarrfikësve.</p> <p>2. Në shenjat e funksioneve nga paragrafi 1</p>	<p>1. Signs of PFRU functions are placed in plaques with dimensions 60 x 110 mm composed by a strong fabric with the same colour as the uniform, which are placed at the chest of the fire fighters uniform.</p> <p>2. In the functions insignia under paragraph</p>	<p>1. Znakovi funkcija PJGPS su postavljeni u epoletama sa dimenzijama 60x110mm od trvdog platna sa istom bojom kao uniforma i postavljaju se u naramenicama uniforme za vatrogasce.</p> <p>2. U znakovima funkcija iz stavke 1 ovog</p>



<p>i këtij neni, vendoset shenja e përbashkët e formës së stemës sipas nenit 17, paragrafin 2 të këtij udhëzimi administrativ me diametër prej 15 mm.</p> <p>3. Shenjat e funksioneve prej pikës 1.1. deri te pika 1.6 nga neni 18, kanë kanë shiritin rrethues të paletës me trashësi prej 5 mm dhe shiritat horizontal me ngjyrë ari me gjerësi prej 6 mm dhe 12mm, ndërsa shenjat e funksioneve prej pikës 1.7 deri te pika 1.10 të nenit 18, kanë shiritin rrethues me trashësi prej 5 mm të ngjyrës së kuqe dhe shiritat horizontal me gjerësi prej 6 mm dhe 12mm me ngjyrë ari. Distanca në mes shiritave është 6mm.</p> <p>4. Përzgjedhja e shenjave të funksioneve të pjesëtarëve të NJPZSH-së sipas këtij neni bëhet përmes konkursit publik, pas të cilit njëra nga tri propozimet më të mira do t'i afrohet AME-së për miratim.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Vendosja e shenjave të funksionit</b></p> <p>1. Në uniformën e punës dhe uniformën solemne, pjesëtarët e NJPZSH-së janë të obliguar të vendosin shenjat e funksioneve sipas nenit 19 të këtij udhëzimi administrativ.</p>	<p>1 of this article, shall be placed the common sign of seal shape according to the article 17 paragraph 2 of this administrative instruction with diameter of 15mm.</p> <p>3. Functions insignias under point 1.1. to the point 1.6. from article 18 have the perimeter strap of the plaque with 5 mm thickness and gold horizontal straps with 6 mm and 12 mm width, while the functions insignias under point 1,7 to the point 1.10 of article 18 have the perimeter red strap with 5 mm thickness and the horizontal gold strap with 6 mm and 12 mm width. The distance between the straps shall be 6 mm.</p> <p>4. Selection of function insignias for FPRU members under this article shall be made by a public announcement after which one of the there best proposals shall be submitted to EMA for approval.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>Placement of function insignia</b></p> <p>1. In the work uniform and solemn uniform, PFRU members shall be obliged to place the function insignias under article 19 of this Administrative Instruction.</p>	<p>člana, se postavlja zajednički znaka oblika grba prema člana 17 stavka 2 ovog Administrativnog Uputstva od 15 mm.</p> <p>3. Znakovi funkcija od tačke 1.1 do tačke 1.6 iz člana 18 imaju traku okruženja epolete debljine od 5 mm kao i horizontalne trake zlatne boje širine od 6 mm i 12 mm, dok znakovi za funkcije od tačke 1.7 do tačke 1.10 iz član 18 imaju traku okruženja debljine od 5 mm crvene boje kao i horizontalne trake širine od 6 mm do 12 mm zlatne boje. Odstojanje između traka je 6 mm.</p> <p>4. Izbor znakova funkcija za članove PJGPS prema ovom članu se vrši preko javnog konkursa, nakog kojeg jedna od najboljih predloga će biti dostavljena AEM-u za usvajanje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Stavljanje znakova funkcija</b></p> <p>1. Na radnu uniformu i svečanu uniformu, članovi PJGPS su obavezni da stave znakove funkcija prema članu 19 ovog Administrativnog Uputstva.</p>
---	---	---



<p>2. Në mantelin mbrojtës nga shiu, si dhe në uniformë mbrojtëse nuk është e obliguar të vendosen shenjat e funksionit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b> <b>Vendosja e shenjave të përkatësisë</b></p> <p>1. Shenjat që dëshmojnë përkatësinë e pjesëtarit të NJPZSH-së vendosen sipas përshkrimit në vijim:</p> <p>1.1. shenja e NJPZSH-së vendoset në pjesën e përparme të kapeles së uniformës;</p> <p>1.2. shenja e AME-së vendoset në mëngën e djathtë të uniformës - 5 cm nga tegeli i epërm;</p> <p>1.3. shenja e NJPZSH-së vendoset në mëngën e majtë të uniformës - 5 cm nga tegeli i epërm.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b> <b>Vendosja e shenjave të fushëveprimit përkatës</b></p> <p>1. Sipas fushëveprimit përkatës, në kapakun e xhepit të majtë të uniformës, vendosen shenjat e cekura si në vijim:</p> <p>1.1. shenja për instruktorë;</p> <p>1.2. shenja për aksidente të komunikacionit rrugor;</p> <p>1.3. shenja për ndihmë të parë;</p>	<p>2. In the rain protective coat and in the protective uniform it is not obliged the placement of function insignias.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 21</b> <b>Placement of affiliation signs</b></p> <p>1. Signs which prove the affiliation of the PFRU members shall be placed under the following description:</p> <p>1.1. The PFRU sign shall be placed in the front side of the uniform hat.</p> <p>1.2. The EMA sign shall be placed in the right sleeve of the uniform – 5 cm from the upper bight</p> <p>1.3. The PFRU sign shall be placed in the left sleeve of the uniform – 5 cm from the upper bight.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 22</b> <b>Placement of signs for the respective scope</b></p> <p>1. Under the respective scope, at the left pocket flap shall be placed the following signs:</p> <p>1.1. instructor insignia</p> <p>1.2. traffic accidents insignia</p> <p>1.3. first aid insignia</p>	<p>2. U zaštitnom mantilu za kišu, kao i u zaštitnoj uniformi nije obavezno da se stave zankovi funkcija.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 21</b> <b>Stavljanje znakova pripadnosti</b></p> <p>1. Znakovi koji dokazu pripadnost člana PJGPS se stavljaju prema opisu u nastavku:</p> <p>1.1. Znak PJGPS se stavlja u prednjem delu kape uniforme.</p> <p>1.2. Znak AEM-a se stavlja u desni rukav uniforme – 5 cm od gornjeg šava.</p> <p>1.3. Znak PJGPS se stavlja u levi rukav uniforme – 5 cm od gornjeg šava.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 22</b> <b>Stavljanje znakova dotične oblasti delovanja</b></p> <p>1. Prema dotičnoj oblasti delovanja, u poklopac levog đepa uniforme se stavljaju pomenuti znakovi u nastavku:</p> <p>1.1. znak za instruktore,</p> <p>1.2. znak za saobraćajne nesreće na putevima,</p> <p>1.3. znak za prvu pomoć,</p>
--	--	--



<p>1.4.shenja për zhytje në ujë; 1.5.shenja për punë me materie të rrezikshme.</p> <p>2.Shenjat e fushëveprimit përkatës të pjesëtarëve të NJPZSH-së janë të metalta me dimensione 30 x 35mm dhe përzgjedhja e tyre bëhet përmes konkursit publik, pas të cilit njëra nga tri propozimet më të mira do t'i afrohet AME-së për miratim.</p> <p style="text-align: center;"><b>DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b></p> <p>1. AME – ja është e obliguar që në afatin prej 2 vite të harmonizoj dhe unifikoj uniformën dhe shenjat e funksioneve për të gjitha NJPZSH-të në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi administrativ.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b></p> <p>Pjesëtarët e NJPZSH-së, të cilët janë në funksionet aktuale mund të mbajnë shenjat funksionale vetëm derisa të kryejnë atë funksion.</p>	<p>1.4. water diving insignia 1.5. work with hazardous materials insignia.</p> <p>2. Insignias of the relevant functions for PFRU members shall be metallic with dimensions of 30 x 30 mm and their selection shall be made through a public announcement, after which one of the best proposals shall be sent to EMA for approval.</p> <p style="text-align: center;"><b>TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 23</b></p> <p>1. EMA shall be obliged to harmonize and unify the uniform and the functions insignia for all PRFU within 2 years and in compliance with the provisions of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 24</b></p> <p>Members of PFRU, who are currently under function, may carry the functions insignia only upon the completion of that function.</p>	<p>1.4. znak za ronioce na vodu, 1.5. znak za rad sa opasnim metrijama.</p> <p>2. Znakovi dotične oblasti delovanja za članove PJGPS su od metala sa dimenzijama 30x35 mm i njihov izbor se vrši preko javnog konkursa, nakon kojeg jedna od tri najboljih predloga se dostavlja AEM-u za usvajanje.</p> <p style="text-align: center;"><b>PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 23</b></p> <p>1. AEM-je dužan da u roku od 2 godine usklađuje u unificira uniformu i znakove funkcija za sve PJGPS u skladu sa odredbama ovog Administrativnog Uputstva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 24</b></p> <p>Članovi PJGPS, koji su u aktuelnim funkcijama mogu nositi znakove funkcija samo dok vrše tu funkciju.</p>
--	--	--



<b>Neni 24</b> <b>Hyrja në fuqi</b>	<b>Article 24</b> <b>Entry into force</b>	<b>Član 24</b> <b>Stupanje na snagu</b>
<p>Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Punëve të Brendshme.</p>	<p>This administrative instruction enters into force on the day of signature by the Minister of Internal Affairs.</p>	<p>Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu dana njegovog potpisivanja od strane Ministra Unutrašnjih Poslova</p>
<p><b>Bajram Rexhepi</b>  <b>Ministri i Punëve të Brendshme</b> <b>Data:</b> <u>10/08/2012</u></p>	<p><b>Bajram Rexhepi</b>  <b>Minister of Internal Affairs</b> <b>Date:</b> <u>10/08/2012</u></p>	<p><b>Bajram Rexhepi</b>  <b>Ministar Unutrašnjih Poslova</b> <b>Datum:</b> <u>10/08/2012</u></p>





## **SHTOJCA 1**

### **Modeli dhe specifikat teknike për uniformën e punës**

#### **Neni 1**

#### **Kapela**

1. Kapela është e punuar nga pëlhura me ngjyrë të kaltër të mbylltë me përbërje 50 % të pambukut të tkurrur dhe 50 % poliesterit, është e formës eliptike dhe ka mbrojtje nga dielli me një gjatësi prej 70 – 80 mm.
2. Në fundin e kapelës është qepur një shirit i cili mbërthehet me një kapëse të metaltë me ngjyrë të kaltër të mbylltë. Nga ana e brendshme e kapelës është vendosur një astar nga pambuku me ngjyrë të përhimtë, ndërsa fundi i kapelës është i përforcuar me një shirit të gjerësisë 30 mm për thithjen e djersës.
3. Në pjesën e përparme të kapelës vendoset shenja e NJPZSH-së.

#### **Neni 2**

#### **Këmisha**

1. Këmisha është me ngjyrë të kaltër të mbylltë me përbërje prej 100 % të pambukut të tkurrur, me pjesën e përparme e hapur në tërë gjatësinë, ndërsa mbërthehet me shtatë pulla të mbuluara dhe një pullë në qafë në anë të djathtë dhe tetë vrima në anë e majtë.
2. Në pjesën e përparme në lartësinë e gjoksit janë të qepur dy xhepa me kapakë të cilët mbërthehen me pulla.
3. Në pjesët anësore nga të dy anët e fundit të këmishës nga 10 cm ka prerje. Dy pjesë të përparme të këmishës janë të punuara në formë ovale.
4. Në kraharorët e këmishës janë të qepur mbajtësit për paletat me shenjat e funksioneve të cilat mbërthehen me pulla.
5. Pjesa e prapme e këmishës është e prerë në lartësinë e shpatullave. Në mesin e pjesës shpinore të këmishës nga tegelat kah pjesa e poshtme është e punuar një palë dyfishore me gjatësinë prej 30 cm.
6. Mëngët në pjesën e epërme janë të qepura për kraharorin e këmishës, ndërsa pjesët e poshtme përfundojnë me kapak mënge me gjerësinë 7 cm, me një vrimë dhe pullë në mes.
7. Mëngët janë të prera në lartësinë e tegelit në anën e përparme në gjoks dhe tegelit në pjesën e shpinës dhe përfundojnë me dy palë dhe një prerje në pjesë të pasme.
8. Këmisha për femra është identike me atë të meshkujve, vetëm që pjesa e djathtë mbërthehet nga ana e majtë.
9. Shenjat që dëshmojnë përkatësinë e pjesëtarit të NJPZSH-së, vendosen sipas përshkrimit në neni 21, nënparagrafin 1.2 dhe 1.3.

#### **Neni 3**

#### **Pantallonat**

1. Pantallonat janë me ngjyrë të kaltër të mbylltë, me prerje të gjerë, me përbërje të njëjtë si xhaketa. Në pjesën e epërme në anën e majtë dhe të djathtë kanë nga një xhep me prerje të pjerrtë.
2. Në anën e majtë dhe anën e djathtë në lartësinë mbi gjunjë, janë të qepur dy xhepa në formë harmonike me kapak të cilët mbërthehen me pulla.



3. Në pjesën e pasme të pantallonave janë të qepur dy xhepa me kapakë të cilët mbërthehen me kapëse.
4. Në pantallonat rreth brezit janë të qepur numër i nevojshëm i mbajtësve të rripit, me gjerësi 6 cm.

#### **Neni 4 Xhaketa**

1. Xhaketa përbëhet prej dy pjesëve të përparme dhe një pjesë të prapme dhe mëngëve, duhet të jetë komode dhe me gjatësinë normale 15 cm nën bel. Xhaketa është e punuar prej pëlhure me ngjyrë të kaltër të mbylltë me përbërje prej 50% pambuk të tkurrur dhe 50 % poliesterit. Në pjesën e përparme xhaketa është e hapur në tërë gjatësinë, ndërsa hapja mbyllet me patentë mbyllës dhe kapakë me kapëset metalike me ngjyrë të kaltër të mbylltë.
2. Në pjesën e përparme të xhaketës në lartësinë e gjoksit janë të qepur dy xhepa me kapakë të cilët mbërthehen me kapëset, mbi kapakët e xhepit janë të qepur shirita – rrodhëza në të cilët ngjiten shiritat, në anë të djathtë emri e mbiemri, – funksioni në njësinë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit. Nën xhepat e epërm në lartësinë e bërrylit gjenden xhepa të prerë pjerrtas të cilët mbërthehen me patentë mbyllës.
3. Shenjat që dëshmojnë përkatësinë e pjesëtarit të NJPZSH-së vendosen sipas përshkrimit në neni 21, nënparagrafin 1.2 dhe 1.3.
4. Në kraharorë janë të qepur mbajtësit për paletat me shenjë të funksionit, ndërsa mbërthehen me pulla me ngjyrë të kaltër të mbylltë.
5. Mëngët janë të punuara prej dy pjesëve, ndërsa në fund përfundojnë me një shirit të gomës me gjerësinë 5 cm. Pjesa shpinore e xhaketës është e punuar prej një pjese dhe në çdo anë gjenden tegelat të kthyer kah kraharorët.
6. Xhaketa ka brezin i cili është punuar prej gome me gjerësinë prej 5 cm dhe përfundon me një pëlhurë ku në skajet e tyre janë kapëse metalike, ndërsa në anë të brendshme është vendosur astari sintetik.

#### **Neni 5 Xhupi**

1. Xhupi ka shtresë të brendshme është me ngjyrë të kaltër të mbylltë. Prej pjesës së kraharorit deri te lartësia e gjoksit dhe përmes shpinës, është e përforcuar dhe ka shtresën e brendshme që arrin deri te fundi i mëngës dhe mund të hiqet me patentën mbyllëse.
- Xhupi ka brezin dhe kapelën. Në pjesën e poshtme të xhupit nga të dy anët janë të vendosura dy xhepa të thella me kapakë.
3. Xhupi është me gjatësinë e duhur / përshtatshme dhe arrin deri mbi gjunjët.
  4. Shenjat që dëshmojnë përkatësinë e pjesëtarit të NJPZSH-së vendosen sipas përshkrimit në neni 21 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3. të këtij udhëzimi administrativ.

#### **Neni 6 Fanella me mëngë të shkurta**

1. Fanella me mëngë të shkurta është me ngjyrë të kaltër të mbylltë, me mëngë të shkurta dhe e përbërë prej materialit 100 % të pambukut të tkurrur.
2. Në pjesën e përparme në anë të majtë në lartësinë e gjoksit është qepur shenja e NJPZSH-së.



## **Neni 7**

### **Dorëzat e punës**

